

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga KKCG Group AG, me seli në rr. Kapellgasse 21, 6004 Lucern, Zvicër, të dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve GEORGI DIMITROV Avokatë Shkup, në seancën e mbajtur më 20.05.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin KKCG Group AG, me seli në rr. Kapellgasse 21, 6004 Lucern, Zvicër, do të fitojë kontroll indirekt të vetëm mbi Inter Terminals Sweden AB, me seli të regjistruar në rr. Smerjoljegatan 21, 418 34 Göteborg, Mbretëria e Suedisë, dhe Inter Terminals Denmark A/S, me seli të regjistruar në rr. Holtengårdsvej 25, 4230 Skælskør, Mbretëria e Danimarkës, përmes shitblerjes aksioneve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë të tij thelbësore, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumën prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 21.04.2026, ndërsa i plotësuar më 04.05.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga KKCG Group AG, me seli në rr. Kapellgasse 21, 6004 Lucern, Zvicër, me të cilin KKCG Group AG, nëpërmjet shoqërisë së saj të varur Goldcup 39308 AB, me seli të regjistruar në adresën BOX 270, 851 04 Sundsvall, Stokholm, Mbretëria e Suedisë, do të fitojë kontroll të vetëm mbi Inter Terminals Sweden AB, me seli të regjistruar në rr. Smerjoljegatan 21, 418 34 Göteborg, Mbretëria e Suedisë, dhe nëpërmjet shoqërisë së saj të varur Inter Terminals Denmark Holding APS, me seli të regjistruar në adresën c/o Moalem Weitemeyer Advokatpartnerselskab, rr. Amaliegade 3, 1256 Kopenhagë, Mbretëria e Danimarkës, do të fitojë kontroll të vetëm mbi Inter Terminals Denmark A/S, me seli të regjistruar në rr. Holtengårdsvej 25, 4230 Skælskør, Mbretëria e Danimarkës, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim, plotësimit të tij dhe dokumentacionit bashkëlidhës, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

KKCG Group AG është shoqëria mëmë e grupit korporativ KKCG (në tekstin e mëtejshëm: „KKCG Group“). KKCG Group investon në fusha të ndryshme të biznesit, duke përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, sektorin e energjisë, pasuritë e paluajtshme dhe teknologjinë e informacionit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, KKCG Group është e pranishme në tregun e menaxhimit të terminaleve të video lotarisë dhe në sektorin e teknologjisë së informacionit (IT), dhe ka shoqëritë e varura në vijim:

- Shoqëria për Organizimin e Lojërave të Fatit CASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MAQEDONIA SHPK Shkup, me seli në bulevardin „Kiro Gligorov“ nr. 2, Shkup – Gazi Babë, me veprimtari prioritare 92.000 – veprimtari të lojërave të fatit dhe basteve;
- Shoqëria për Organizimin e Lojërave të Fatit Lotaria Shtetërore e Video lotarisë e Republikës së Maqedonisë – CASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me seli në bulevardin „Kiro Gligorov“ nr. 2, Shkup – Gazi Babë, me veprimtari prioritare 92.000 – veprimtari të lojërave të fatit dhe basteve;
- Shoqëria për Teknologji Informatike AVENGA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. „11-ti Oktomvri“ nr. 33A, Shkup – Qendër, me veprimtari prioritare 62.100 – programim kompjuterik;
- Shoqëria për Arsimim Kompjuterik dhe Zhvillim të Inovacioneve AVENGA ACADEMY SHPKNJP Shkup, me seli në rr. „11-ti Oktomvri“ nr. 33A, Shkup – Qendër, me veprimtari prioritare 85.590 – arsim tjetër i papërmendur në vend tjetër;
- Shoqëria për Prodhim, Tregti dhe Shërbime MUSALA SOFT SHPKNJP Shkup, me seli në rr. „11-ti Oktomvri“ nr. 33A, Shkup – Qendër, me veprimtari prioritare 62.100 – programim kompjuterik, aktualisht shoqëri joaktive.

Inter Terminals Sweden AB dhe Inter Terminals Denmark A/S janë aktive në sektorin e infrastrukturës, me një rrjet strategjik terminalesh për magazinimin e lëngjeve në sasi të mëdha në Danimarkë dhe Suedi, përkatësisht. Ato janë aktive në dy segmente kryesore:

- logjistika e integruar (terminale të lidhura me transportin e karburanteve nëpërmjet tubacioneve, transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror, të cilat mbështesin rafineritë dhe klasterët industrialë); dhe
- magazinimi i lëngjeve në sasi të mëdha.

Inter Terminals Sweden AB dhe Inter Terminals Denmark A/S nuk kanë shoqëri të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk kanë realizuar të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ